

Dr. Riza SADIKU

## SHËNIMI I PËRVJETOREVE TË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT, TË MËRGATËS SHQIPTARE NË SHBA-së

Traktati i Shën Stefanit i lidhur në mes të Perandorisë Osmani dhe Rosisë, në mars të vitit 1878, në të cilin parashihej copëtimi dhe kolonizimi i territoreve shqiptare, dëshpëroi pa masë tërë popullin shqiptar. Rezultati i Traktatit në fjalë preku edhe interesat politike dhe strategjike të fuqishme të kohës, prandaj disa shtete, gjatë vitit 1878, filluan të përgatisin Kongresin e Berlinit, për revidimin e Traktatit të Shën Stefanit. Në këto rrethana politike yndyra e ndërgjegjes kombëtare, më 10 qershor të vitit 1878, në Prizren organizon Kuvendin historik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili në historinë e popullit shqiptarë paraqet ngjarjen më të rëndësishme të kohës më të re. Në këtë Kuvend, delegatët shqiptarë, përfaqësonin thuajse të gjitha trojet e natyrshme të Shqipërisë Etnike, nën Perandorinë Osmane, përmes të cilit, ia bëjnë me dije opinionit evropian dhe shteteve vendimmarrëse si dhe grabitqare të kohës, se tokat shqiptare janë të pandashme, për të cilat luftuan gjatë shekujve të kaluar për ti çliruar ato nga Perandoria Osmane, jo për tu ripushtuar dhe kolonizuar nga sllavët.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Athanas Gegaj, *Lidhja e Prizrenit, FLAMURI, organ i Ballit Kombëtar*, nr. 15-16,

Lidhja e Prizrenit është shprehja ma vigane e popullit shqiptar kundrejt rrezikut ma të madh që i kërcënohej kombit autokton të një gjuhe, të një tradite e të një gjaku .

Në frymën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit lindi ideja e Shqipërisë Etnike dhe Shqipëria e Shqiptarëve, të cilat terma u bënë bazament i fortë i atdhedashurisë dhe i platformës politike të Ballit Kombëtar, me rastin e themelimit të kësaj organizate, më 13 qershor të vitit 1939, si dhe sinonim i afirmimit, propagandimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes mbarëkombëtare shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Platforma politike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, edhe pse u kundërshtua ashpër gjatë të gjitha periudhave historike nga politika grabitqare e shteteve fqinje e udhëhequr nga Beogradi dhe e përkrahur nga Moska, ajo, për çdo shqiptar të ndërgjegjshëm, është bërë një shtyllë e fortë për zgjedhjen e drejtë të çështjes kombëtare, andaj le ta dinë miqtë dhe armiqtë e popullit shqiptar, deri sa çështja kombëtare nuk zgjidhet mbi parimet e platformës politike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, nuk do të ketë paq në Ballkan.

Populli shqiptar, për shkak të copëtimit të territoreve të natyrshme etnike, të cilat copëtime janë legjitimuar nëpër Kongrese dhe Konferenca ndërkombëtare të Paqes, u janë nënshtruar politikave të dhunshme asimiluese dhe shkombëtarizuese, nga shtetet pushtuese fqinje, andaj për këto arsye kanë qenë të detyruar të shpërngulen dhe emigrojnë në shtete dhe kontinente të ndryshme të botës, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas fatit tragjik të marrëveshjes së Mukjes në gusht të vitit 1943, dhe triumfit të ideologjisë komuniste në trojet etnike shqiptare, në fund të vitit 1944, fillon ndjekja më e vrazhdë dhe më e tmerrshme e veprimtarëve të çështjes kombëtare, qëllimi i të cilëve ishte dhe mbeti bashkimi i trojeve etnike në një shtet të natyrshëm shqiptar i bazuar në vendimet e Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<sup>2</sup>

---

mars-prill 1951, Romë, f. 3.

2 Shih gjerësisht, Uran Butka, *Gjeniu i kombit - Kuvendi i Mukjes dhe Mid'hat*

Një numër i veprimtarëve të devotshëm të çështjes kombëtare, të cilët arritën tu shpëtojnë pushkatimeve, burgosjeve dhe ndjekjeve komuniste, emigruan jashtë atdheut duke u vendosur në fillim në kamp-strehimore të ndryshme të Italisë, Greqisë, Turqisë dhe vende tjera të Evropës, Azisë, Amerikës dhe Australisë. Pas konsolidimit të tyre, filluan aktivitetin politik dhe kombëtar sipas rrethanave dhe kërkesave të reja të kohës. Nga organizatat politike të cilat, jo vetëm që vepronin në mërgim, për afirmimin e platformës politike të trashëguar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, por në bazë të së cilës, me mburrje dhe krenari, kanë kërkuar zgjedhjen e çështjes mbarëkombëtare, zëdhënëse më të fuqishme dhe të zjarrta ishin: Balli Kombëtar, Lidhja Kosovare, Komiteti Shqipëria e Lirë dhe Grupi Shqiptar Demokrat-Independent me qendër në Stamboll, të cilat platformën e tyre politike e mbështetnin në Dekalogun e Mid'hat Frashërit, djalit të Abdyl Frashërit, themeluesit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<sup>3</sup> Në këtë frymë në mërgim vepronte edhe Legaliteti, Blloku Idependent, Lidhja Shqiptare e Prizrenit me seli në Nju Jork, Lidhja Çame me qendër në Çikago e tjera organizata politike.

Me konsolidimin e radhëve të organizatave të lartpërmendura, në mërgim, me qëllim të afirmimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes mbarëkombëtare, mërgata shqiptare, përmes mjeteve të informimit, sidomos gazetave dhe buletineve, me rastin e përvjetorëve, në veçanti të jubileve, filluan të botojnë artikuj dhe fejtone, jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, turqisht etj., për rëndësinë dhe vendimet e Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të mbajtur më 10 qershor të vitit 1878.<sup>4</sup>

---

*Frashëri*, Tiranë, 2000, f. 387-405.

3 Riza Sadiku, *Kontributi i Lidhjes Kosovare në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare 1949-1999*, tezë e doktoraturës në dorëshkrim, e mbrojtur më 7 korrik 2003 në Institutin Albanologjik, Dega e Historisë, Prishtinë, f. 9.

4 Gjerësisht shiko: *Njiqind-vjetori i Lidhjes së Prizrenit, 1878-1978*, New York, Chicago, Detroit, qershor-korrik 1978.

Veprimtaria serioze kombëtare e organizatave politike në mërgim, filloi të respektohet dhe të legjitimohet nga qeveritë e shteteve perëndimore, të cilat ua mundësuan të anëtarësohen në organizata të ndryshme ndërkombëtare, përmes të cilave në mënyrë institucionale i shprehnin orientimet dhe kërkesat e tyre politike për zgjedhjen e çështjes shqiptare, në bazë të platformës të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<sup>5</sup>

Organizatat në fjalë, përmes mjeteve të informimit, shkruanin jo vetëm artikuj të ndryshëm, por edhe fejtone. Njëra ndër gazetatat, në të cilën më së shumti u shkrua dhe u propagandua platforma politike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte gazeta “Flamuri”, organ i Ballit Kombëtar, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaja. Njëri ndër njohësit më të mirë të Lidhjes së Prizrenit i cili ka shkruar në mërgim në gazetën “Flamuri”, për mendimin tim, është edhe Prof. dr. Athanas Gegaj i cili ka botuar shumë artikuj interesant për kuptimin, organizimin, vendimet, politikën dhe luftërat e Lidhjes së Prizrenit, për Prizrenin Kryeqytet të Kombit, për Lidhjen e Prizrenit dhe veprimtarinë e saj në Jug të Shqipnisë, etj.<sup>6</sup>

Në shtypin e mërgatës shqiptare, në gazetën “Flamuri”, punime interesante dhe shumë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar, që kanë të bëjnë me Lidhjen e Prizrenit, ka shkruar edhe Prof. Ibrahim Kelmendi, me titull: “Pak fjalë për të kaluemen e shqiptarëve”.

Mërgata shqiptare, kujdes të veçantë u ka kushtuar edhe përvjetorëve të ngjarjeve të rëndësishme nga historia e popullit shqiptarë, në këtë kontekst është dalluar Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kështu, me rastin e shënimit të 75 vjetorit të saj, gazeta “Flamuri”,

5 Po aty.

6 Gjerësisht: *Lidhja e Prizrenit*, “Flamuri”, nr. 15-16, mars-prill 1951, f. 3; *Politika dhe luftat e Lidhjes së Prizrenit*, “Flamuri”, nr. 17-18, maj-qershor, f. 5; *Prizreni Kryeqytet i Kombit*, “Flamuri” nr. 19-20, korrik-gusht, f. 3; *Lidhja e Prizrenit dhe veprimtaria e saj në Jug të Shqipnisë*, “Flamuri”, nr. 21-22, shtator-tetor 1951, Romë, f. 4.

nr. 42-44, gusht 1953, thujse tërë numrin ia kushton këtij jubileu. Me këtë rast u botuan këta artikuj: Rëndësia e Lidhjes së Prizrenit nga prof. Abas Ermenji; Liga e Prizrenit nga Lumo Skendo, Lidhja e Prizrenit nga At Gjergj Fishta, dhe The Albanian League, nga prof. Stavro Skendi.<sup>7</sup>

Me rastin e shënimit të 80 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në gazetën "Flamuri" botohet artikulli i Sami Frashërit, i 20 shkurtit të vitit 1881, kur ai i shkruan letër Jeronim De Radës. "Këtë përvjetor e shënon edhe gazeta "Besa", Organ i Grupit Shqiptar Demokrat-Idipedent në Turqi, në faqen e parë të gazetës, me titull: "Në këtë qershor mbushi 80 vjet Lidhja e Prizrenit, që organizoi gjithë energjitë kombëtare të 4 vilajeteve kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit"<sup>9</sup>. Gazeta "Besa" e Stambollit, kujdes të veçantë i ka kushtuar edhe 85 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë rast, në faqen e parë të saj botohet artikulli me titull: "Në 85 vjetorin Shqiptarët përkujtojnë me mirënjohje dhe krenari Lidhjen e Madhe të Kombit që filloi në Frashër dhe u realizua në Prizren, për të mbrojtur atdheun nga copëtimi"<sup>10</sup>. Po ashtu e shohim të jetë shkruar e botuar një artikull me rastin e shënimit të 80 vjetorit të LSHP në mërgim, në gazetën "Shqiptari i Lirë", 30 qershor 1958, New York.

Mërgata shqiptare, kujdes të veçantë i kushtoi edhe shënimit të 90 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me të cilin rast në faqen e parë të gazetës "Flamuri", dominoi artikulli i prof. Abas Ermenjit në gjuhën frenge, me titull: "LE 90-e Anniversaire de La Ligue Albanaise de Prizrend", dhe artikulli i Dr. Nihat Bakallit me titull: "Lidhja e Prizerenit"<sup>11</sup>, kurse në gazetën "Besa" në faqe të

7 Gjerësisht shiko: "Pak fjalë për të Kalumen e Shqiptarëve", "Flamuri", nr. 23-24, nanduer -dhetuar 1951, Romë, f. 6,7.

8 "Flamuri", nr. 42-44, Vol. IV (VII), 20 gusht 1953, Romë, f. 1-7.

9 Lidhja e Prizrenit mbushi 80 vjet, Sami Feashëri i shkruan De Radës, "Flamuri", nr. 99-100, vol. VIII (XI), 7 gusht 1958, Romë, f. 3.

10 "Besa", Viti XI-të, nr. 121-122, 16 nëntor 1963, Istanbul, f. 1.

11 Gjerësisht shiko: "Flamuri", nr. 165-168, vjeti XIX (XXII), 28 nëntor 1968,

parë u botua artikulli me titull: "90 Vjetori i Besëlidhjes Kombëtare në Prizren"<sup>12</sup>. Po ashtu vlen të përmendet edhe artikulli në gjuhën frënge i cili i kushtohet Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me rastin e shënimit të 90-të vjetorit të saj, botuar në gazetën "Flamuri", 28 nëntor 1968.

Ngjarjeve të rëndësishme nga historia e popullit shqiptar, mërgata shqiptare gjithmonë u ka kushtuar rëndësi të veçantë. Më 18 prill 1970, Federata Panshqiptare e Amerikës "VATRA" organizoi një seminar mbi çështjen shqiptare, me të cilin rast, në këtë seminar fton profesorin e mirënjohur të Vjenës, njohësin e shkëlqyeshëm të çështjes shqiptare dr. Robert Shfanke, i cili mbajti ligjëratën shumë interesante me titull: "Lidhja e Prizrenit dhe Austro-Hungaria"<sup>13</sup>.

Kur bëhet fjalë për përvjetorët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duhet vënë në pah, se 100 vjetori i themelimit të sajë është shënuar në mënyrë madhështore në mërgim, jo vetëm që kjo ngjarje historike ka dominuar në shtypin e mërgatës, por janë organizuar edhe simpoziume të veçanta.<sup>14</sup> Në Nju Jork, simpoziumi shkencor kushtuar 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, organizuar nga Balli Kombëtar, Komitetit Demokrat Shqipëria e Lirë dhe Lidhja Kosovare është mbajtur më 24 dhe 25 qershor 1978 në Hotelin Sheraton. Për rëndësinë historike të Lidhjes së Prizrenit, kumtesa kanë lexuar: Prof. Vasil Andoni, dr. Ali Koprenska, Dr. Jani Dilo, Gjon Pjetër Gjonmarkaj, Dr. Sami Repishti, Prof. Stavro Skendi, Prof. Luan Gashi dhe Prof. Abas Ermenji. Në Çikago përvjetori jubilar u shënuar më 3 korrik. Këtë simpozium e përshëndetën shumë personalitete të administratës amerikane, në mesin e të cilëve edhe senatori Çarls Percy, kurse fjalimin historik e ka mbajtur Prof. Abas Ermenji. Në Detroit, përvjetori është mbajtur

---

Romë, f. 1,2, 6, 7.

12 *Besa*, Viti XV nr. 171-174, 6 maj 1968, Istanbul, f. 1.

13 The Pan-Albanian Federation of America "VATRA", New York 1970, (Botim i veçantë).

14 Gjerësisht shiko: *Njiqind-vjetori i Lidhjes së Prizrenit, botim i veçantë*, f. 164, Romë 1978. "Flamuri" nr. 216-218, vjeti XXVIII (XXXI), 28 nëntor 1978, Romë, f. 2,3,4,, 9, 10, 11.

më 9 korrik, këtë jubile e madhëroi përshëndetja e kongresistit të Miçingenit Z. Derzinski, kurse për rëndësinë historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit foli Prof. Abas Ermenji.<sup>15</sup>

Shënimi i vitit jubilar të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u bë edhe në gazetën "Kosova", organ i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Nju Jork dhe e Komitetit Kombëtar në Kanada.

Duhet theksuar se nga ky simpozium, mërgata shqiptare, përkatësisht Komiteti Kombëtar Demokrat "Shqipëria e Lirë" më 28 nëntor 1978 në Romë të Italisë, botoi librin e veçantë prej 164 faqesh, me titull: "Njiqind-vjetori i Lidhjes së Prizrenit 1878-1978".

Kur bëhet fjalë për shënimin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në mërgim, këtë përvjetor më 2 shtator 1978, në hotelin "Nju Jork Sheraton", me pietet të lartë e përkujton edhe Federata Pan Shqiptare "VATRA", Lidhja e Prizrenit, Legaliteti dhe organizatat tjera me seli në Nju Jork. Për rëndësinë historike të LSHP ka folur dr. Rexhep Krasniqi Me tema të veçanta u paraqiten: Zonja Nermine Vlora Falaski me temën Rëndësia e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, prof. Zef Nekaj me kumtesën e tij me titull Lidhja Prizrenit në epikën gojore, kurse Z. Elez Biberaj, ka folur për veprimtarinë ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Shqipëri Veriore 1878-1881. Të gjitha këto punime janë botuar në një libër të veçantë nga "Vatra" në Nju Jork, në vitin 1978, me titull: "Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1978".<sup>16</sup> Organi i "Vatrës", gazeta "Dielli" e datës 16 qershor 1978, në faqen e parë boton artikullin me titull: "100 Vjetori i Lidhjes së Prizrenit"<sup>17</sup>. Këtij jubileu rëndësi të veçantë i kushtoi edhe organizata politike, "Lidhja Çame" me seli në Çikago, e cila me këtë rast, tërë numrin e 14 të revistës "Krahu i Shqiponjës" ia kushton 100 Vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.<sup>18</sup>

15 "Flamuri" nr. 216-218, vjeti XXVIII (XXXI), 28 nëntor 1978, Romë, f. 2,3,4,, 9, 10, 11.

16 Gjerësisht shiko: "Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1978", VATRA, Nju Jork, 1978.

17 "Dielli", Voll. 70, nr. 10, 16 qershor 1978, Boston, f. 1,2.

18 Gjerësisht shiko: "Krahu i Shqiponjës", nr. 14, Chicago, 1978.

Dr. Riza SADIKU

## SUMMARY

**THE ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN ANNIVERSARIES  
CELEBRATION BY THE ALBANIAN EXPATRIATES IN  
THE US**

Albanian expatriates unwavering on their position for 60 successive years made clear statement to allies and enemies of Albanian people that foundations of Albanian ethnic state have been set on Convention of the League of Prizren in 1878 in strong grounds by the "Balli Kombëtar" as guideline for any conscious Albanian. It will be no peace in Balkans and Europe without settling Albanian issue accordingly they emphasised during times of Slav-communist secret service led by the Soviet Union on its peak of domination as a factor on the international stage, and traditional supporter of Serbian politics for partition of Albanian lands. Relevance of anniversaries remembrance for the Albanian League in emigration presents not only maturation of conscience regarding the Prizren League role on the history of Albanian people. Main goal of this remembrance has been and still is propagation and sensibility of unresolved Albanian issue as to political platform of the Albanian League of Prizren, but also to inform American public in general and American administration with real situation of ethnic territories fragmentation by the neighbouring countries.